

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO		
AUTORITETI RREGULLATIV I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE REGULATORNI AUTORITET ZA ELEKTRONSKE I POŠTANSKE KOMUNIKACIJE REGULATORY AUTHORITY OF ELECTRONIC AND POSTAL COMMUNICATIONS		
Nr./Br./No.	045/B/18	
Nr. Faq./Br. St./No. Pg	2	
Data/Datum/Date	03.08.2018	
PRISHTINË - PRISHTINA - PRISHTINA		

VENDIM Nr. 1242

Për

Miratimin e

“Rregullores për shfrytëzimin e brezave të radio frekuencave për të cilat nuk kërkohet autorizim individual dhe kushtet e përcaktuara teknike të përdorimit të radio pajisjeve në këto breza”

Në mbështetje të nenit 1, nenit 10, paragrafi 4), nenit 46 paragrafi 1) paragrafi 2.1) nenit 47 paragrafi 1), neni 54 paragrafi 2.3) dhe paragrafi 2.8), nenit 79, paragrafi 1) dhe 2) dhe nenit 98 të Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikime Elektronike (*tutje referuar si - Ligji*) dhe nenit 10 paragrafi 2.1), nenit 11 paragrafi 3.3) dhe nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të (*Ref. Nr.Prot.054/B/17*) të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si - Autoriteti ose ARKEP*), Bordi i Autoritetit i përbërë nga:

- | | |
|----------------------|------------------|
| 1) z. Kreshnik Gashi | Kryetar i Bordit |
| 2) z. Nijazi Ademja | Anëtar i Bordit |
| 3) z. Hazir Hajdari | Anëtar i Bordit |
| 4) z. Shqiprim Pula | Anëtar i Bordit |

në mbledhjen e 30-të me radhë të mbajtur më datë 23 Korrik 2018, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga DMF dhe DL, mori këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet “Rregullore për shfrytëzimin e brezave të Radio frekuencave për të cilat nuk kërkohet Autorizim Individual dhe kushtet e përcaktuara teknike të përdorimit të radio pajisjeve në këto breza”.
- II. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Ligji, respektivisht neni 10, paragrafët 4) përcakton se Autoriteti: “Miraton legjislacionin sekondar lidhur me këtë ligj, të cilat janë në kompetencë të Autoritetit, mbështetur në dispozitat e këtij ligji.”



Neni 46 paragrafi 2.1 i Ligjit përcakton që: "Resurset e komunikimeve elektronike mund të shfrytëzohen pa kurfarë autorizimi, kur Autoriteti vendos që resurset e caktuara të komunikimeve elektronike mund të shfrytëzohen pa autorizim."

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i shfrytëzimit të resurseve frekuencore për të cilat nuk kërkohet Autorizim Individual për radio frekuenca si dhe definon kushtet të cilat duhet të përmbushen nga një radio pajisje gjate përdorimit të tyre në brezat e frekuencave të përcaktuara në këtë rregullore.

Përmes kësaj rregullore përcaktohen rregulla të qarta për dhënien e resurseve të komunikimeve elektronike duke u udhëhequr nga parimi i efikasitetit dhe efektivitetit të shfrytëzimit të frekuencave si dhe obligimet dhe rekomandimet që dalin nga traktatet relevante ndërkombëtare që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e radio-frekuencave.

Duke pas parasyshë atë që u tha më lartë u vendos sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

Prishtinë, 03/08/2018

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Kreshnik Gashi
Kryetar i Bordit



Aktvendimi i dërgohet:

- Ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile;
- Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik/Departamenti i Postë Telekomunikacionit dhe Teknologjisë Informativë;
- Departamentit për Menaxhimin e Frekuencave, ARKEP
- Arkivit, ARKEP